

Emri i Lëndës : Jurisprudenca e Jetës së Profetit

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 122	B	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	4.00

Lektori	Nertil Bërdufi, PhD
Asistenti	
Gjuha e kursit	Shqip, Anglisht, Turqisht
Niveli i lëndës	Bachelor
Përshkrimi	Në këtë lëndë do të shpjegohet historia e popullit arab para Islamit, kronologjia e jetës së Profetit (s.a.s) si një personalitet historik, personaliteti i tij dhe veprimtaritë.
Objektivat	Te informoje studentin mbi jetën e Profetit Muhamed (a.s).
Konceptet Kryesore	Studentët do të kenë njohuritë e nevojshme mbi jetën e profetit (s.a.s) si një personalitet historik

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Në këtë temë do të shpjegohet prejardhja e ndritur e Profetit (s.a.s), lindja e tij, vitet që kaloi pranë Mëndeshës, vdekja e nënës së tij Aminës dhe përkujdesja e Abdulmuttalibit. Gjithashtu do të shpjegohet edhe lidhja e martesës me Hatixhen (r.a), ndryshimet që solli kjo martesë në jetën e Profetit (s.a.s) dhe në shoqërinë mekase si dhe do të tregohet për frytet që solli kjo martesë. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq. 15-64.
2	Në këtë temë fillimisht do të shpjegohen shenjat që i vinin Profetit (s.a.s) para ardhjes së shpalljes. Më pas do të shpjegohet fillimi i ardhjes së shpalljes, biseda me Xhebrailin (a.s) dhe reagimet e para të Profetit (s.a.s). Gjithashtu do të përmenden pasuesit e parë që iu përgjegjën ftesës së Profetit (s.a.s), do të shpjegohen vitet e para të mundimshme të muslimanëve dhe qëndrimet që ato mbajtën për të mbrojtur idealin e tyre. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, 65-97.
3	Në këtë temë do të shpjegohet periudha kur kumtesa filloi të bëhej haptazi, vështirësitë që u hasën dhe vendosmëria e atyre që kishin besuar. Do të shpjegohen edhe orvatjet e të dërguarit (s.a.s) për të bindur xhaxhain e tij Ebu Talibin që ai të ishte në mesin e besimtarëve. Gjithashtu do të tregohet edhe për ngjarjet e rëndësishme që ndodhën në shtëpinë e Ibn Erkamit dhe si e shihnin jobesimtarët të dërguarin e Allahut. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, 98-159.
4	Në këtë temë do të trajtohet periudha kur Profeti (s.a.s) i zbritën ajetet që duhet t'i kumtonte të tjerëve duke e zgjeruar rrethin. Do të shpjegohen emigrimet drejt Etiopisë bashkë me urtësitë e tyre. Do të trajtohet mrekullia e ndarjes së hënës dhe reagimet e atyre që nuk besonin. Do të shpjegohen vitet e bojkotit të përgjithshëm dhe vështirësitë që kaluan besimtarët. Së fundmi do të shpjegohet një nga periudhat më të vështira në jetën e Profetit (s.a.s) që njihet ndryshe edhe si viti i trishtimit. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, 160-199.
5	Në këtë temë do të shpjegohet udhëtimi që Profeti (s.a.s) bëri në Taif dhe sprovat me të cilat u përball gjatë këtij udhëtimi. Do të trajtohet ndodhia e Israsë dhe Miraxhit që ndryshe njihet si një nga ndodhitë më të veçanta në jetën e Profetit (s.a.s), dhuratat që Profeti (s.a.s) solli për besimtarët nga ky udhëtim dhe do të shpjegohet rëndësia që mbart kjo ndodhi në jetën e çdo besimtari. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, 200-229.
6	Në këtë temë do të shpjegohen besëlidhjet e Akabesë dhe rëndësia që ato patën në rrjedhën e ngjarjeve që ndodhën më pas. Do të shpjegohet leja që Profeti (s.a.s) mori për Hixhret dhe shqetësimi i Kurejshëve. Gjithashtu do të shpjegohet migrimi i shenjtë dhe ndodhitë më të rëndësishme gjatë migrimit. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, 230-260.

7	Në këtë temë do të shpjegohet periudha kur Profeti (s.a.s) u vendos në Medine, në atdheun i ri. Do të trajtohet ngritja e qytetërimit të ri, mënyra e organizimit të jetesës dhe marrëveshjet që u lidhën mes muhaxhirëve dhe ensarëve. Pasi filloi një epokë e re për besimtarët do të trajtohen edhe masat që ato morën për t'u mbrojtur nga rreziqet që i kanoseshin. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq. 261-280.
8	Provim Gjysmë-final
9	Në këtë temë do të shpjegohet beteja e parë e myslimanëve, beteja e Bedrit. Do të shpjegohen zhvillimet para, gjatë dhe pas kësaj beteje. Do të trajtohet vendosmëria e besimtarëve, ndihma hyjnore dhe forca shpirtërore që kishin besimtarët edhe pse të paktë në numër krahasuar me mosbesimtarët që u përballën. Gjithashtu do të shpjegohen mësimet dhe urtësitë që morën besimtarët nga kjo betejë. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq.281-330.
10	Në këtë temë do të përshkruhet fillimi i ndodhisë së Uhudit. Do të trajtohet hutbeja e Uhudit, përmbajtja e saj dhe rëndësia e saj për besimtarët. Gjithashtu do të shpjegohet disfata e mekasve dhe çfarë i solli besimtarëve mosruajtja e delikatesës në bindjen ndaj urdhërit të Profetit (s.a.s). Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq.331-349.
11	Në këtë temë do të shpjegohen zhvillimet në Uhud ku mund të përmendim; organizimin e besimtarëve, lëkundja që ato pësuan, ndihmesa hyjnore që i erdhi dhe rigrupimi pas ndihmesës hyjnore. Gjithashtu do të shpjegohet koha kur Profeti (s.a.s) dhe shokët e tij i dhanë lamtumirën dëshmorëve të Uhudit dhe ngjarjet në Hamra'ul Esed. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq. 350-374.
12	Në këtë temë do të përshkruhen zhvillimet më të rëndësishme që ndodhën pas Uhudit. Do të analizohen zhvillimet në Hendek, ku do të përfshihen: sfidat gjatë përballjes me jobesimtarët, rëndësia që ka bashkimi për të arritur fitoren, urtësitë e kësaj ngjarjeje dhe çfarë i mësoi besimtarëve përfundimi i Hendekut. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq. 375-397.
13	Në këtë temë do të përshkruhet udhëtimi i besimtarëve për në Umre dhe ndodhitë e këtij udhëtimi. Do të shpjegohet marrëveshja e Hudejbijes dhe urtësitë e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu do të shpjegohet periudha e zgjerimit, si e ndryshuam rrjedhën ngjarjet në Hajber dhe zhvillimet që ndodhën pas Hajberit. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq. 398-440.
14	Në këtë temë do të trajtohet prishja e marrëveshjes me jobesimtarët dhe çfarë zhvillimesh solli prishja e kësaj marrëveshjeje. Më pas do të shpjegohet sihariqi që i erdhi besimtarëve për ngadhënjim, hyrja e tyre në qabe dhe bujaria që treguan besimtarët e triumfit bashkë me Profetin (s.a.s) ndaj mosbesimtarëve. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, fq. 441-460.
15	Në këtë temë do të shpjegohen lajmet e ardhura nga Heuazini dhe impakti që ato patën. Do të shpjegohen themelet e mirëkuptimit në botën e ndritur. Gjithashtu do të përshkruhet haxhi i lamtumirës dhe koha kur Profeti (s.a.s) u nda nga kjo botë. Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013, 461- 494.
16	Final Exam
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• • Reshit Hajllamaz, Profeti ynë (s.a.s), Prizmi, Tiranë: 2013	
Referenca të tjera	
• Ramazan el-Buti, Fikhu's-Sire, Bilge Adamlar Yayınları, İstanbul: 2010 • Vehbi Süleyman Gavoci, Muhammed (savs)	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të mësojnë rreth historisë së arabëve para ardhjes së Islamit, në mënyrë që të jenë më të qarta ndryshimet që ndodhën në atë shoqëri me ardhjen e Profetit (s.a.s.)

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	14	14
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			100
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.00
ECTS			4.00